



JP KOMUNALNE DJELATNOSTI - ULCINJ
NP VEPRIMTARITË KOMUNALE - ULQIN

JAVNO PREDUZEĆE KOMUNALNE DJELATNOSTI
NDËRMARRJA E RE

Br.

344

Nr.

24.02

20

17

god

viti

ULCINJ-ULQIN

VENDIM PËR ÇMIMET E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT TË
MBETURINAVE KOMUNALE NE TERITORIN E KOMUNËS SË ULQINIT

Ulqin, shkurt 2017

Në bazë të Ligjit për veprimtari komunale („Fleta zyrtare e RMZ“ numër 12/95) dhe nenit 22 të Statutit të NP „Veprimtaritë komunale“ Ulqin, Këshilli drejtues i kësaj ndërmarrje në mbledhjen e mbajtur me 23.02.2017, mori:

VENDIM

Për çmimet e shërbimit të transportit të mbeturinave komunale ne teritorin e komunës së Ulqinit

Neni 1

Ndërmarrjet nga lëmia e hotelerisë për objektet brenda kompleksit paguajnë shërbimet e transportit të mbeturinave dhe ambalazheve në bazë të kontratës me NP „Veprimtaritë komunale“ Ulqin si organizatë kompetente për ofrimin e këtyre shërbimeve, ndërsa për objektet jashtë kompleksit (restorantet, agjencitë, depot, magazinët, punëtoritë dhe të ngjashme) sipas m² në bazë të pikave tarifore të vendimit ku jenë përfshirë.

Shfrytëzuesit e shërbimeve nga ky nen kontraktimin e kryejnë në fillim të vitit kalendarik, ndërsa shfrytëzuesit me karakter sezonal 10 ditë para hapjes së objektit, në të kundërt do të implementohet tarifa në bazë të pikës tarifore ku janë përfshirë, sipas m² ose objektit.

Neni 2

Çmimi i shërbimeve të mirëmbajtjes së pastërtisë së qytetit përcaktohet në këto shuma:

Ndërmarrje nga lëmia e hotelerisë për objektet brenda kompleksit dhe ndërmarrjet tjera paguajnë shërbimet e transportit të mbeturinave sipas turës – kontejnerit në bazë të kontratës me NP „Veprimtaritë komunale“ Ulqin si organizatë kompetente për ofrimin e këtyre shërbimeve, ndërsa për objektet jashtë kompleksit (restorantet, agjencitë, depot, magazinët, punëtoritë dhe të ngjashme) sipas m² në bazë të pikave tarifore të vendimit ku jenë të përfshirë.

Shfrytëzuesit e kontejnerëve nga neni paraprak janë të detyruar që të kontraktojnë të paktën katër (4) tura në muaj, përveç nëse është e paraparë ndryshe me çmimore.

Me shfrytëzuesit e shërbimeve nga ky nen kontrata nënshkruhet në kohë të pacaktuar, përveç se nëse në të kundërt vjen deri tek shkëputja e kontratës.

Neni 3

Çmimi i shërbimeve të mirëmbajtjes së pastërtisë së qytetit për kategorinë e amvisërive dhe ekonomisë përcaktohen në këto shuma:

Nr. rend.	Emri i shërbimit	Njësia matëse	Çmimet e propozuara	Shënim
1.	➤ Transporti/deponimi i mbeturinave shtëpiake nga hapësirat banuese (amvisëritë) ➤ Ndërtesat banuese (amvisëritë) ➤ Kompensimi për mbeturinat inerte për amvisëri ➤ Çmimi i shërbimeve për objektet private për qiradhënien e shtretërve (shtëpitë, apartamentet), për shtrat për sezon	m² m² Vendi Për shtrat	0.060€ Të paktën 3,50€ 1,50€ 5,00€ për sezon	
2.	Hapësirat kancelarike ➤ Auto shkollat ➤ Agjencitë ➤ Libraritë ➤ Shtypshkronjat ➤ Byrotë për projektim dhe të tjerë	m ²	1.14€ më së shumti 28.60€	
3.	Institucionet tjera ekonomike ➤ Bankat ➤ Entet siguruese ➤ PTT ➤ Elektrodistribucioni ➤ Ujësjiellës dhe kanalizimit ➤ Organizata turistike	m ²	0.50€	
4.	Shfrytëzuesit e stacioneve të autobusëve, parkingjeve dhe pikave të karburantit ➤ Pikat e karburantit, ➤ Stacionet e autobusve		257,40€ 257,40€	
5.	Prodnice maloprodajne prehrambene robe: ➤ Minimarketët, dyqanet e fruta-perimesh, mishtoret ➤ Dyqanet mbi 200 m² - Megamarketët	Deri 20m² 20-40m² Sipas kontratës	1.43€ 54.34+1.00/m² Në bazë të numrit të kontejnerëve	Jo më pak se 4 tura
6.	Objektet e lojërave të fatit: ➤ Bastoret sportive ➤ Kazinotë, automat klubet		28.60 vendi 57.20 vendi	
7.	Dyqanet me shumicë ➤ Diskontët (pije dhe ushqim) ➤ Dyqanet me shumicë, mallrat ushqimore ➤ Diskontët e ushqimit të bagëtisë	Deri 50m² +50m² A më së shumti	1.14/m² 57.20+1.00€/m² 114.40 € 57.20 vendi	
8.	Dyqanet e tekstileve ➤ Butikët ➤ Komisionet ➤ Butikët e mallrave të ndryshme	m² më së shumti	1.14€ 57.20€ 114.40€	

9.	Dyqanet e mallrave teknike dhe mobileve ➤ Dyqanet e teknikës së bardhë ➤ Dyqanet e elektro-materialeve dhe atyre të ujit ➤ Sallonet e mobileve: 0-200 m² 201-500 m² mbi 501 m² ➤ Qendra tregtare	Do 40m ² + 40m ² Vendi Vendi Vendi Vendi	1.14€ 45.76+1.00€/m ² 57.20 114.40 228.80 Për kontejnerë 5-7m ³	Të paktën 4 tura në muaj
10.	Dyqanet e zanatçinjve: Autoserviset, dyqanet e marangozëve, dyqanet metalo-përpunuese Deri 50 m ² 51-100 m ² 101-200 m ² Mbi 200 m ² ➤ Gomisteritë ➤ Autolarjet (lavazhet)	 Vendi Vendi Vendi Vendi Vendi Vendi	 42.90 57.20 85.80 114.40 42.90 42.90	
11.	Objektet hotelerike me kuzhinë: ➤ Restorantet ➤ Kuzhinat popullore	Deri 40m ² +40m ²	1.29€/m ² 51.48+1.00€/m ²	
12.	Objektet hotelerike me kuzhinë, më të vogël: ➤ Piceritë ➤ Hamburgerët ➤ Byrektoret ➤ Qebaptoret ➤ Ëmbëltoreset dhe pastiçeritë ➤ Çajtoreset ➤ Furrat e bukës	Deri 50m ² +50m ²	1.00€/m ² 50.05+0.86€/m ²	
13.	Objektet hotelerike pa kuzhinë: ➤ Kafenetë ➤ PUB-et ➤ Banakët e hapur ➤ Klubet e natës, disko-klubet	Deri 40m ² +40m ² +40m ² +40m ² +40m ²	1.29€/m ² 51.48+1.14€/m ² 51.48+1.14€/m ² 51.48+1.14€/m ² 51.48+1.14€/m ²	Për objektet në Ranë për sezonin veror rritet 200%
14.	Institucionet shëndetësore dhe të tjera ➤ Kinematë ➤ Shtëpitë e kulturës ➤ Institucionet shëndetësore ➤ Organet e administratës ➤ Fondet dhe shoqatat ➤ Radio stacionet ➤ Gjykatat ➤ MPB, etj.	m ²	0.36€/m ²	

15.	Institucionet shkollore dhe parashkollore	m ²	0.25€/m ²	
16.	Depot e materialeve ndërtimore: ➤ Depot e materialeve ndërtimore dhe prodhimeve tjera industriale	m ²	0.29€/m ²	
17.	Shfrytëzuesit e hapësirave industriale: ➤ Fabrikat për përpunimin e ullinjve ➤ Fabrikat e prodhimeve nga tekstili ➤ Fabrikat e dyshekëve ➤ Fabrikat e mobileve ➤ Fabrikat për përpunimin e kripës ➤ Fabrikat për përpunimin e letrës		71.50€ 85.80€ 114.40€ Për kontej. 5-7m ³ Për kontej. 5-7m ³ 57,20€	Sipas kontratës (të paktën 4 tura në muaj)
18.	Depot (magazinat): ➤ Shfrytëzuesit e magazinës (depove)	m ²	0.14€/m ²	
19.	Shitësit jashtë tregut: ➤ Automobilat ➤ Furgonët ➤ Kamionët ➤ Në rrugë	Në ditë Vendi	2,00€ 5,00€ 7,00€ 28,60€	
20.	Shfrytëzuesit e hapësirës për cirk dhe luna park:	Në ditë	11.44€	
21.	Veprimtaritë ekonomike ➤ Konservatorët për akullore ➤ Vitrinat ftohëse ➤ Stendat për kioskë ➤ Zgarat për misër (kallamboq) ➤ Pjekja e gështenjave, kokoshkave, krepave, karamеле pambuku, etj. ➤ Rekvizitët për plazh ➤ Stendat e librave	Muaj Muaj Muaj Muaj Muaj Muaj Muaj	28.60€ 28.60€ 42.90€ 42.90€ 35.75€ 28.60€ 28.60€	
22.	Objektet hotelerike në plazh	Muaj	171.60€	+ tarifa verore
23.	Hotelet, pushimoret dhe kampet ➤ Hotelet dhe pushimoret ➤ Objektet turistike me kapacitete të vogla me përmbajtje të tipit hotelarik (pansion, gjysmëpansion, motelet, vilat dhe të ngjashme) ➤ Autokampet ➤ Kamp-shtëpizat	m ² 0 - 400 401 -800 Mbi 800 Njësia Njësia	Për kontratë 114.40€ muaj 228.80€ muaj 343.20€ muaj 50.00€ 60.00€	Për kont. 4 kont. 8 kont. 12 kont.

24.	Transporti i mbeturinave nga kontejnerët			
	➤ Transporti i mbeturinave nga kontejner 1,1m ³	Tura	28.60€	
	➤ Transporti i mbeturinave nga kontejner deri 5-7m ³ (deri në 5 km)	Tura	71.50€	
	➤ Transporti i mbeturinave nga kontejnerët deri 5-7m ³ (më shumë se 5 km)	Tura	100,90€	
	➤ Transporti i mbeturinave nga kontejnerët 7-11m ³	Tura	150,00€	
	➤ Transporti i mbeturinave nga kontejnerët mbi 11m ³	Tura	200,00€	
	➤ qiradhënia e kontejnerëve 1,1 m ³	Vendi	28,50€	
	➤ qiradhënia e kontejnerëve 5-7 m ³	Vendi	71,50€	
25.	Për kategorinë ekonomike përcaktohen këto shuma:			
	➤ kioskat për shitjen e gazetave, duhanit dhe bizhuterisë	Deri 12m ²	1,43€	
	➤ lulishtet	Më së shumti	21,45€	
	➤ fotokopirët			
	➤ robaqepësit dhe këpucëtarët			
	➤ videotekat			
	➤ TV serviset			
	➤ dyqanet kozmetike			
	➤ argjendaritë			
	➤ orëndreqësit			
	➤ avoketët			
	➤ dyqanet optike			
	➤ fotografët			
26.	Parking hapësirat dhe garazhet			
	➤ Auto taksitë	Vendi.	3,00€	
	➤ Auto transportuesit	Vendi.	4,00€	
	➤ Parking hapësirat dhe garazhet	m ²	0,14€	
27.	Aktivitetet sportive rekreative			
	➤ Palestrat	Vendi	28,60€	
	➤ Sallat sportive	Vendi	28,60€	
28.	Shoqëritë ekonomike për kryerjen e punimeve ndërtimore dhe të ngjashme			Të paktën 2 tura
	➤ Kompanitë ndërtuese	Vendi	Për kontej. 5-7m ³	
	➤ Fabrikat e betonit	Vendi	57,20€	
	➤ Gur thyesit	Vendi	57,20€	
29.	Restorantet për dasma dhe të ngjashme	Për dasmë	Për kontejner 5-7m ³	

Neni 4.

Për të gjithë objektet e përkohshme me karakter sezonal (për periudhën e sezonit të verës) çmimet rriten 100% pavarësisht nga zona ku ndodhen.

Për objektet hotelerike, të cilët janë në numrin rendor 13 dhe të cilët ndodhen në shetitoren e Detarëve të Ulqinit, çmimet do të rriten për 200% për sezonin veror.

Neni 5.

Objektet tjera afariste, të cilët nuk kanë karakter sezonal, për periudhën e sezonit veror vlera e shërbimit komunal do të paguhet në varësi nga zona ku do të përfshihen. Zonat janë të ndara sipas kësaj renditje:

- I. Përfshinë zonën e Plazhit të vogël, rreth ish hotelit Galeb, rrugën e re, zonën nga plloça deri tek tregu i gjelbër, duke përfshirë vendbanimin Mëhalla e re, dhe nga bulevardi Teuta, Plazhin e madh, vendbanimin Shtoj dhe Adën e Bunës.
- II. Përfshinë magjistralen dhe pjesën tjetër të zonës së qytetit ku nuk bëjnë pjesë zona I
- III. Përfshinë vendbanimet periferike.

Viti kalendarik do të ndahet në dy sezone nga të cilët:

- Sezoni dimror nga 01.10 deri me 31.05
- Sezoni veror nga 01.06 deri me 30.09

Neni 6.

Shërbimet komunale për objektet të cilët janë përfshirë në Zonën I do të rriten për 80% për periudhën e sezonit veror.

Shërbimet komunale për objektet të cilët janë përfshirë në Zonën II do të rriten për 40% për periudhën e sezonit veror.

Shërbimet komunale për objektet të cilët janë përfshirë në Zonën III do të rriten për 20% për periudhën verore.

Neni 7.

Për shfrytëzuesit e shërbimeve të karakterit sipërmarrës të cilët nuk u përmendën në mënyrë specifike në pikat e sipërthëna faturimi do të bëhet në bazë të kategorisë së përafërt ku bëjnë pjesë.

Neni 8.

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi për korrektimin e çmimeve të shërbimeve të transportit të mbeturinave në teritorin e Komunës së Ulqinit nr.1356 e datës 14.12.2007.

Neni 9.

Ky vendim hynë në fuqi me dhënien e pëlqimit nga ana e Kuvendit komunal të Ulqinit.

Këshilli drejtues,
Kryetari,
Amir Hollaj

